



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 640 Prot

Tiranë, më 05/6/2020

REKOMANDIM

Nr. 5, datë 05/6/2020

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “PREFEKTI I QARKUT DURRËS”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <http://prefektidurres.gov.al/index.php/programi/>, të Autoritetit Publik “Prefekti i Qarkut Durrës” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozite, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet

përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në ikonën “Transparenca”, dhe Programi i Transparencës është ndërlidhur në këtë ikonë.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, nuk janë të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse (nuk janë plotësuar me informacion).

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”).

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për

koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji.

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por, të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plotë: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Prefekti i Qarkut Durrës, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 05.6.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Prefekti i Qarkut Durrës– datë 04.06.2020

Prefekti i Qarkut Durrës ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun:<http://prefektidurres.gov.al/index.php/programi/>

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në ikonën “Transparenca”, dhe Programi i Transparencës është ndërlidhur në këtë ikonë.



Nga monitorimi rezulton se, Programi i Transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, nuk janë të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse (nuk janë plotësuar me informacion).




<



7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.

Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit


<http://prefektidurres.gov.al/index.php/struktura-2/dhe>

<http://prefektidurres.gov.al/index.php/rregullore-institucionit/por> nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;





7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit <http://prefektidurres.gov.al/index.php/legjislacioni> por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;**



Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Data ligjore	Dokument / Përshkrim	Adesi kuher për publikim	Shtypja e publikimit	Struktura përgjegjëse
Procedurat e strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të institucioneve të Prefekturës	Nëna 7/14/11/2014	Struktura organizative e Prefekturës së Durresit nr. 04 dt. 10.08.2008 dhe ndryshimet nr. 119 dt. 07.11.2008 i Kryeministrit	Mesazhi për publikim në faqen e internetit	Kujdesi me kujdes për publikim në faqen e internetit	Koordinatori i Gjetjes së informacionit dhe ndërlidhjes me strukturat e tjera
Akte nënligjore ligje, akte nën ligjore, dokumente politike, dokumente tjera	Nëna 7/14/11/2014				
Informacioni për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresat, portat dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe	Nëna 7/14/11/2014	Modeli i kërkesës			Grua e punës






7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim gjendet i publikuar pjesërisht në faqen e autoritetit <http://prefektidurres.gov.al/index.php/kerkese-per-informacion/> por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës. Mungon informacioni për procedurat e ankimit të vendimit përkatës;**

The screenshot shows a web browser window displaying the 'Model Kërkesë për Informim' (Information Request Form) on the website of the Prefecture of Durrës. The form is titled 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE' and 'PREFEKTI I QARKUT DURRES'. It includes fields for 'Emri i kërkuar' (Name requested), 'Adresa postare' (Postal address), 'Adresa elektronike' (Electronic address), 'Nr. Tel.' (Phone number), and 'Data' (Date). Below these fields, there is a section for 'Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar' (Detailed description of the information requested) with several lines for text entry. The form is presented within a window frame with a standard Windows taskbar at the bottom.

7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit <http://prefektidurres.gov.al/index.php/kordinatori/> por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës (në program figuron koordinators tjetër);**

The screenshot shows a web browser window displaying contact information for the 'Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun' (Public Relations Specialist) on the website of the Prefecture of Durrës. The text displayed is: 'Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun', 'Lori Muço', 'E-mail: prefekti.durres@mb.gov.al', 'Tel 0697857606', 'Hëno-Enjte 08:00-16:30', and 'Premte 08:00-14:00'. The page is titled 'PREFEKTI I QARKUT DURRES' and includes a navigation menu at the top. The page is presented within a window frame with a standard Windows taskbar at the bottom.





7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Programi i Transparencës (Pth) | +

Hot secure | prefektdunet.gov.al/index.php/program/

REPUBLIKA SHQIPTARE
PRESIDENTI DHE KRYETARI

KRYE | RAZETI NISM | LEGJISLACIONE | EMERGENCA CIVILE | TRANSPARENCA | FUNKSIONE TE DELEGUARA | AKTIVITETE | KONTAKT

Përbërjen e procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksioneve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/14	Prefekti emerohet nga Kryetari i Ministrisë, Nënprefekti emerohet nga Ministri i Punëve të Brendshme			
Mekanizmat monitorues: raporte audit, dokumentet me tërheqje performancë	Neni 7/17 dhe				
Buxheti	Neni 7/18				
Informacioni për procedurat e prokurimit	Neni 7/19				
Shërbimet e automjetit për publikun	Neni 7/19				
Parapajsa e mendimeve në hartimin e planit, etj.	Neni 7/19				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/19		Vendimorë		G. Stajka
Regjistrimi i kërkesave	Neni		Vendimorë		G. Stajka

31-08 AM 6/4/2019

7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Programi i Transparencës (Pth) | +

Hot secure | prefektdunet.gov.al/index.php/program/

REPUBLIKA SHQIPTARE
PRESIDENTI DHE KRYETARI

KRYE | RAZETI NISM | LEGJISLACIONE | EMERGENCA CIVILE | TRANSPARENCA | FUNKSIONE TE DELEGUARA | AKTIVITETE | KONTAKT

Përbërjen e procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksioneve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/14	Prefekti emerohet nga Kryetari i Ministrisë, Nënprefekti emerohet nga Ministri i Punëve të Brendshme			
Mekanizmat monitorues: raporte audit, dokumentet me tërheqje performancë	Neni 7/17 dhe				
Buxheti	Neni 7/18				
Informacioni për procedurat e prokurimit	Neni 7/19				
Shërbimet e automjetit për publikun	Neni 7/19				
Parapajsa e mendimeve në hartimin e planit, etj.	Neni 7/19				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/19		Vendimorë		G. Stajka
Regjistrimi i kërkesave	Neni		Vendimorë		G. Stajka

1:08 PM 6/4/2019

[KREU](#) | [RRETHI DHEM](#) | [LEGJISLACIONE](#) | [EMERGENJENCA CIVILE](#) | [TRANSPARENCA](#) | [FUNKSIONE TE DELEGUATA](#) | [AKTIVIZETE](#) | [KONTAKT](#)

Prokurimi i procedurave te regjistrimit, kompetencave te funktionarve te larte dhe procedurave te ndjekjes per rastet e vandalizimit	Neni 7.1.f)	Preklad nendoret nga Karablis i Ministresve, Njeresish te nendoret nga Ministri, Punetore te Brendeshore		
Miksimisht nendoret, raporte audit, dokumente me nivele performances	Neni 7.1 dh)			
Braktet	Neni 7.1.e)			
Informacione per procedurat e prokurimit	Neni 7.1.f)			
Shprehjet e autoritetit per publikim, Parapies e mundesive ne hartimin e paketeve, etj.	Neni 7.1.i)	Neni 7.1.j)		
Mjetet e dokumentimit nga AP	Neni 7.1.h)		Vazhdimshme	O. Shjaka
Rregjionet e Mbrojtjes	Neni		Vazhdimshme	O. Shjaka

3

[illegible]

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Informacioni për shërbimet	Statusi	Shërbimet e autoritetit publik	Standardet për cilësinë e shërbimit
Informacioni për shërbimet	Në pritje		
Shërbimet e autoritetit publik	Në pritje		
Parashikimi i menjëhershëm i kërkesave dhe përgjigjeve	Në pritje		
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Në pritje	Vendimtar	G. Stajka
Rregullimi i kërkesave	Në pritje	Vendimtar	G. Stajka


dhe përgjigjeve, sipas nevojës	Statusi	Shërbimet e autoritetit publik	Standardet për cilësinë e shërbimit
dhe përgjigjeve, sipas nevojës	Në pritje		
Informacioni dhe dokumentacioni	Në pritje		
Informacioni të tjera të detyrueshme	Në pritje		

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Informacioni për shërbimet	Statusi	Shërbimet e autoritetit publik	Standardet për cilësinë e shërbimit
Informacioni për shërbimet	Në pritje		
Shërbimet e autoritetit publik	Në pritje		
Parashikimi i menjëhershëm i kërkesave dhe përgjigjeve	Në pritje		
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Në pritje	Vendimtar	G. Stajka
Rregullimi i kërkesave	Në pritje	Vendimtar	G. Stajka

dhe përgjigjeve, sipas nevojës	Statusi	Shërbimet e autoritetit publik	Standardet për cilësinë e shërbimit
dhe përgjigjeve, sipas nevojës	Në pritje		
Informacioni dhe dokumentacioni	Në pritje		
Informacioni të tjera të detyrueshme	Në pritje		

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik. **Informacioni nuk është i publikuar;**



Informacioni për procedurat e punës	Data	Statusi	Shënime
Procedura e hartimit të ligjeve	7/1/2	Nuk është i publikuar	
Procedura e hartimit të politikave publike	7/1/3	Nuk është i publikuar	
Procedura e hartimit të dokumenteve të punës	7/1/4	Nuk është i publikuar	
Procedura e hartimit të dokumenteve të punës	7/1/5	Nuk është i publikuar	
Procedura e hartimit të dokumenteve të punës	7/1/6	Nuk është i publikuar	
Procedura e hartimit të dokumenteve të punës	7/1/7	Nuk është i publikuar	

Informacioni për dokumentet e punës	Data	Statusi	Shënime
Dokumentet e punës	7/1/8	Nuk është i publikuar	
Dokumentet e punës	7/1/9	Nuk është i publikuar	
Dokumentet e punës	7/1/10	Nuk është i publikuar	
Dokumentet e punës	7/1/11	Nuk është i publikuar	

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Programi i Transparencës (Detyrë)

← → ↻ | Not logged in | prefektidurres.gov.al/index.php/program/

REPUBLIKË E SHQIPËRIE
PRESIDENTI I QARKUT DUE DUE

KREU | KËRTHI I NËSH | LEGJISLACIONE | EMERGENCA CIVILE | TRANSPARENCA | FUNKSIONE TË DELEGUARA | AKTIVITETE | KONTAKT

Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7.1.4				
Shërbimet e autoriteteve për publikum	Neni 7.1.5				
Parapaja e menedhjeve të hartimit e planëve, etj.	Neni 7.1.6				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7.1.7	Vazhdimisht			O. Stajke
Regjistri i kërkesave	Neni 7.1.8	Vazhdimisht			O. Stajke

5

drejt përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji ne 119/2014	7.1.9				
Informacione dhe dokumente që kërkesat shpreh	Neni 7.1.10				
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7.1.11				

12:03 PM 6/4/2020

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji -Informacioni citohet se gjendet i publikuar në faqen e autoritetit <http://prefektidurres.gov.al/index.php/regjistri-i-kerkesave/>por nuk aksesohet. Gjithashtu nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.

Programi i Transparencës (Detyrë)

← → ↻ | Not logged in | prefektidurres.gov.al/index.php/program/

REPUBLIKË E SHQIPËRIE
PRESIDENTI I QARKUT DUE DUE


KREU | KËRTHI I NËSH | LEGJISLACIONE | EMERGENCA CIVILE | TRANSPARENCA | FUNKSIONE TË DELEGUARA | AKTIVITETE | KONTAKT

Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7.1.4				
Shërbimet e autoriteteve për publikum	Neni 7.1.5				
Parapaja e menedhjeve të hartimit e planëve, etj.	Neni 7.1.6				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7.1.7	Vazhdimisht			O. Stajke
Regjistri i kërkesave	Neni 7.1.8	Vazhdimisht			O. Stajke


5

drejt përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji ne 119/2014	7.1.9				
Informacione dhe dokumente që kërkesat shpreh	Neni 7.1.10				
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7.1.11				

12:03 PM 6/4/2020



7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh–**Informacioni nuk është i publikuar;**



7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm nga autoriteti publik. **Informacioni nuk është i publikuar;**

Programi i Transparencës | Foru

← → ↻ ↻ ↻ Nivellimi | përkohësisht.gov.al/index.php/programi/


 REPUBLIKA E SHQIPËRIE
 PRESIDENTI I QKUTIT DHE KRIJES

KREU | PËRTHËNËSH | LEGJISLACION | EMERGENJENCA CIVILE | TRANSPARENCA | FUNKSIONET E DELEGUARA | AKTIVITETE | KONTAKT

Informacion për procedurën e procedurës	Neni 7/12				
Shërbimet e kushtetimit për publikun	Neni 7/13				
Pasqija e monitorimit të hartimit të planit të	Neni 7/14				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/15	Vazhdimi			G. Stajko
Regjistrimi i kërkesave	Neni 7/16	Vazhdimi			G. Stajko

5

drejtësi gjyqësore, sipas nenet 6 të kësaj ligjeje	7/17				
Informacione dhe dokumente që kërkojnë shpesh	Neni 7/18				
Informacione të tjera të diskutueshme	Neni 7/19				

14:33 PM 6/4/2019

Autoriteti Publik	Prefekti i Qarkut Durrës
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrate A.P	Pjesërisht
7.1.bTekst. e plota të konventa, ligje, akteve	Pjesërisht
7.1.cProcedura për kërkesë për informacion	Pjesërisht
7.1.çTë dhënat e vendodhjes së AP	Po
7.1.dTë dhënat për arsim,pagat	Pjesërisht
7.1.dh Auditi	Jo
7.1.e Buxheti	Jo
7.1.ë Procedurat e Prokurimit	Jo
7.1.f Shërbimet e A.P	Jo
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Jo
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.1.i Regjistri i kërkesave	Jo
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Jo
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Jo